1. Endra e të sëmurit.
2. Endra që e bën njerinë xhunub (palarë).
3. Endra e ati që merakoset ditën e i cili ato sheh edhe natën.
4. Endra e ati që fellon në mejtimin e ushqimit gjithënjë.
5. Endra e gruasë (vetëm se në qoftë besëtare me mirvetija).

* * *

Djelli kur lint, kur perëndon, kur është në kubbet, ëndra nuk tregohet, gruasë të paditur, armikut nuk i lajmërohet po mikut që të hdo munt t'ja tregosh fshehur.

Kur sheh një ëndër të mirë, ZOT-it mëshirë plot e lavdëro! Kur sheh një ëndër erësirë «frikso» edhe lutu: o ZOT! të ligën ma largo, masandaj vobekët i përgëzo me sadaka se mundet të çporet e keqja.

Parathënjes tjatrit i thuaj: ëndra të qoftë hajir edhe sa të munç ja përkëthe për mirë. Ay që tregon ëndrën fjalë të tepër mos shtojë, mos gënjejë se bën gjynah të math. Dija e ëndravet është një dijë e duhur se si cili rop kur sheh një ëndër hajir, në atë rugë të mirë që ka nisur vazhdon, kur sheh një ëndër erësirë, vehten e ndalon.

Në këtë dijë dijetarë më të mbëdhenj kan erdhur i ndjeri Muhammed Sirini dhe Muhiddini arebija të cilët mi këtë degë na kanë lënë shkrime për jetë pra: si me atë qëllim që të ja lemë kujtim kombit Shqiptar, që me kohë e kishin përkthyer edhe neve këtë dijë në gjuhën Shqip, po sot me sa që na i kërkuanë shumë

vëllezër e vumë edhe në shtyp. Në këtë dijë kemi marë para sysh edhe atë Tabir namenë e madhe, të re që ka lënë kujtim i ndjeri A. M. Sulejmani, i cili librën e vet e ka përmbledhur prej gjith libravet ëndrë rëfenjëse që janë në botë.

Si ç'do çpikje që shohim në jetë ashtu edhe ëndra është një dritë që na njofton madhërin edhe plot fuqinë e ZOT-it me të math vetë, se pa do një shkak ëndrën në trut kush ta përfytyron? ngjarjen kush ta figuron? padyshim do të themi se këtu mbretëron vetëm ajo fuqi e vërtetë që i di gjith qëllimet e fshehta si dhe gjith ngjarjet që do të ngjasin në jetë.

Kur bëhej lufta e përgjithëshme Murshidi im Haxhi Sulejman Efendiu (sel-lemehyll-llâh) që ish Halifat i Tarakatit Nakshi në xhamin e madhe Fatih kur na jepte vazë, urdhëroj e tha: «këto dit kemi paqë se sot pashë një ëndër: dy lopë duke se bënin luftë me njëra tjetrën, njëra këputi sisët e tjatrës edhe e mposhti» për çudi ato dit u çpall paqë.

Një ditë Imami Eazemi sheh në ëndër si kur hapi var e të mirit Pejgamber edhe koskat e uruar i përmbledh mbi gjoksin e vet. Imami Eazemi ish friksuar tepër, por dijetari Muhammed Sirini ja shpjegoj: Ja Imam! «tinë sheriatin e Hazret Muhammed Mustafajt do t'a zhvillosh edhe në botë do t'a përhapish sheshit». Me të vërtetë Imami Eazemi u bë një dijetar që gjer më kijamet nëmërohet me gisht. Zoti mëshirë plot qëllimet edhe punimet t'ona i përkëtheftë për mbarë edhe na pjektë me ata të mirit lajmëtarë edhe dijetarë amin!